
Komisioni i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kuzhina Qendore” e mbajti mbledhjen e parë

Është mbajtur takimi i parë i Komisioni të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kuzhina Qendore”.

Gjatë kësaj mbledhje u bë konstituimi i komisionit dhe anëtarët u informuan në lidhje me gjendjen aktuale të ndërmarrjes si dhe u morën dy vendime të rëndësishme:

- Me propozimin e anëtarëve të Komisionit, u miratua dhe ndryshua Statuti i Ndërmarrjes Publike Lokale “Kuzhina Qendore”;
- Komisioni mori vendim për shpalljen e konkursit publik për katër (4) pozita për anëtarë të bordit të drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Kuzhina Qendore” SH.A. Konkursi do të shpallet së paku në një (1) gazetë të përditshme në Republikën e Kosovës, si dhe në faqet zyrtare të Komunës së Prishtinës i cili do të përmbajë kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare, si dhe Statutit të ndërmarrjes publike lokale “Kuzhina Qendore” SH.A. Konkursi do të shpallet me datë 04.08.2020 dhe do të jetë i hapur deri me datë 19.08.2020.

Prishtinë, 3 gusht 2020
